

## **Fjala e Guvernatorit**

Prej mëse një viti, Banka e Shqipërisë paraqet vlerësimin e vet mbi ekonominë shqiptare, arritjet, dështimet dhe tronditjet që ajo ka pësuar si pasojë e krizave politike.

\* \*  
\*

Viti 1999 filloi me një situatë ekonomike relativisht të qëndrueshme dhe situatë politike disi më të qetë, por ende të pakonsoliduara. Arritja e objektivave të programit ekonomik më 1998, krijoi një bazë të mirë për të parë më me optimizëm vitin 1999. Objektivat për vitin 1999 u përcaktuan po aq ambiciozë sa edhe një vit më parë. Parashikohej përsëri një rritje e shpejtë vjetore e ekonomisë me 8 për qind, ruajtje e stabilitetit të çmimeve të arritura në vitin 1998 si dhe intensifikim i procesit të privatizimit të njësive të mëdha ekonomike ku dua të veçoj privatizimin e bankave shtetërore.

**Në përgjithësi, tremujori i parë i vitit 1999 shfaq një tendencë pozitive**, me arritje objektivash, sidomos në fushën e politikës monetare, me një rigjallërim të aktivitetit ekonomik privat, me rritje të konsiderueshme të eksporteve (73 për qind në krahasim me një vit më parë), me monedhë stabël. Por, më i spikatur mbetet reduktimi i vazhdueshëm i inflacionit. Në fund të marsit 1999 norma vjetore e inflacionit arriti në 3.2 për qind nga 8.7 për qind në fund të dhjetorit 1998, për t'u reduktuar më tej gjatë muajve prill e maj. Në fund të muajit maj janë arritur vlera negative të tij (-0.06 për qind) gjë që tregon se **plotësimi i objektivit të inflacionit pothuaj është arritur**.

Banka e Shqipërisë, duke ndjekur këto zhvillime, ka ulur vazhdimisht, me të paktën 1 për qind, normat minimale të interesit për depozitat me afat në bankat shtetërore. Në fund të tremujorit të parë të vitit 1999 norma për depozitat tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmuajore ishte 15.5, 15.5 dhe 15 për qind përkatësisht. Deri më sot normat janë ulur dhe dy herë të tjera duke arritur nivelin 13 për qind për depozitat me afat dymbëdhjetë muaj. Qëllimi kryesor i uljes së normave të interesit ka qenë reduktimi i kostos së financimit në ekonomi. Megjithatë, në asnjë rast nuk është çenuar interesi real pozitiv.

Banka e Shqipërisë, ka mbajtur brenda kufijve të vendosur në program objektivat monetarë sasiorë të saj. Oferta e parasë gjithsej është rritur në masën 4.6 për qind. Me politikën e saj të shtrënguar monetare ajo ka ndihmuar në uljen e normës së inflacionit.

Banka e Shqipërisë, duke iu përmbajtur dhe angazhimeve të marra në nënshkrimin e marrëveshjes ESAF 2, ka miratuar një sërë rregullash për të forcuar e qartësuar kuadrin rregullator ligjor bankar. Nga ana tjetër, ajo vazhdon të ketë politikë të saj

zgjerimin e sistemit bankar duke nxitur hyrjen e bankave të reja në tregun shqiptar. U bë tashmë traditë që sa herë përpilohet dokumenti i vlerësimit të ekonomisë të përmendet dhe të paktën një bankë e re e licencuar prej Bankës së Shqipërisë. Në mars 1999 filloi aktivitetin e saj Banka FEFAD, e cila është një bankë e angazhuar në kreditimin sidomos të biznesit të vogël e të mesëm. Licencimi i saj shton kështu subjektet bankare të angazhuara në aktivitetin kreditues, për të cilin ka shumë nevojë ekonomia shqiptare.

Prej mëse tre vitesh Shqipëria është një vend që gjeneron krizë të brendshme ose ka pësuar nga krizat në rajon. Kjo ka patur ndikimin e vet të drejtpërdrejtë në fushën e investimeve. Kriza e rëndë e vitit 1997 çoi vendin në pragun e luftës civile. Ajo u pasua nga përpjekjet për stabilizim më 1998. Por, edhe viti 1998 nuk “i shpëtoi” krizave. Turbullirat e vjeshtës në vend, konflikti në Kosovë por edhe kriza financiare në Azi Juglindore e Rusi, qenë të mjaftueshme për të frenuar investimet. Vendi ndodhet përballë mungesës së investimeve të mëdha e serioze jo vetëm të huaja, por edhe të vendit, mosrealizimit të projekteve si dhe vonesave në procesin e privatizimit. Të gjitha këto kanë tkurrur tregun e punës. Gjithashtu, nga reforma në administratë (shkurtimi i strukturave buxhetore) është shtuar kontigjenti i të papunëve. Kështu, fundi i marsit 1999 ka normën më të lartë të papunësisë (17.95 për qind) që prej vitit 1995. Vetëm për tre muaj (nga dhjetori 1998) papunësia është rritur me dy mijë vetë.

Edhe tremujori i parë i vitit 1999 nuk i shpëtoi përsëritjes së “historisë së krizave”. Qetësimi relativ i situatës politike në vend, që të paktën krijonte premisë për të mos gjeneruar krizë të brendshme, nuk e shmangu dot vendin nga sfidat e ballafaqimit me ngjarje të paparashikuara. Konflikti në Kosovë dhe precipitimi, do të thoja, i menjëhershëm i ngjarjeve, si dhe paqartësitë për kohëzgjatjen e luftës shtuan paqartësitë për drejtimin që do të merrte ekonomia e vendit.


Qeveria reagoi duke bllokuar shpenzimet për investime dhe për rritjen e pagave, me qëllim përballimin e kostos së të shpërngulurve me dhunë. Por, kjo ishte e pamjaftueshme për të administruar çrregullimin e krijuar. Situata, siç e dimë tashmë të gjithë, u arrit të administrohej edhe si pasojë e reagimit të menjëhershëm dhe mbështetjes së komunitetit ndërkombëtar. Megjithatë, përsëri u frenuan investimet, privatizimi dhe kryerja e reformave strukturore duke ulur shanset për konsolidim të ekuilibrave makroekonomikë në afat të mesëm. Gjithësesi, ashtu si në vitin 1998, edhe në vitin 1999, arritja e objektivave më kryesorë të programit ekonomik duket e realizueshme. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë mendon se autoritetet ekonomike të vendit tashmë duhet të interesohen shumë seriozisht pikërisht për zhvillimin afatmesëm të vendit.

## **Shkëlqim Cani**

### **Guvernator**

## I. Objektivat finalë të vitit 1999

Viti 1998 mund të konsiderohet si vit kur u rivendosën ekuilibrat makroekonomikë, ndonëse tepër të brishtë. Objektivat makroekonomikë të



përcaktuar në programin ESAF 2 për vitin 1998 në përgjithësi u arritën; rritja rreth 8 për qind, inflacioni në 8.7 për qind, monedha e vendit përgjithësisht e qëndrueshme dhe deficitin i llogarisë korrente ra në 6 për qind të PPB-së.


Në arritjen e këtyre objektivave dha ndihmesën edhe politika monetare, e cila u materializua në përmbushjen e të gjithë objektivave sasiorë monetarë të paraparë në ESAF. Për më tej, ajo përkoi dhe me një disiplinë relativisht të shtrënguar fiskale të zbatuar nga ana e Qeverisë. Pjesa e deficitit buxhetor të financuar me burime të brendshme, ishte nën kufirin maksimal të përcaktuar. Përmbushja e objektivave nuk u çënua, as nga turbullirat e vjeshtës së vitit 1998 as nga acarimi i krizës në rajonin e Ballkanit.

Arritjet e vitit 1998 krijuan një ndjenjë optimiste për drejtimin që do të merrnin ngjarjet ekonomike në vitin 1999. Duke patur parasysh arritjet e politikave të ndjekura gjatë vitit 1998 si dhe angazhimet që Shqipëria ka ndërmarrë në marrëveshje me FMN-në, u përcaktuan dhe objektivat për t'u arritur në vitin 1999. Si elementi kryesor i programit të këtij viti mbeti ruajtja e stabilitetit të nivelit të çmimeve. **Është parashikuar që në fund të vitit inflacioni të reduktohet më tej, në 7 për qind, në kushtet kur synohet një nivel i rritjes ekonomike të vendit në masën 8 për qind.** Për arritjen e këtij objektiv Banka e Shqipërisë mendon të vazhdojë aplikimin e një politike të matur monetare.


Politikat makroekonomike do të jenë në harmoni me ruajtjen e një inflacioni me tendencë në rënie. **Stabiliteti fiskal mendohet të konsolidohet më tej duke kufizuar deficitin buxhetor të financuar së brendshmi në 5.5 për qind të PPB-së.**

Element i rëndësishëm në programin ekonomik të vitit 1999 mbetet vazhdimi i reformës strukturale, e cila gjatë vitit 1998 nuk ka qenë e suksesshme. Pa përmendur edhe njëherë këto mosrealizime, për vitin 1999 prioritetet qëndrojnë në : shpejtimin e privatizimit (përfshirë edhe bankat shtetërore); përfundimin e

procesit të transparencës së shoqërive piramidale; reduktimin e punonjësve të sektorit buxhetor në 130 000 në fund të marsit 1999; forcimin e kuadrit ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës në të cilin veprojnë bankat dhe të masave në drejtim të luftës kundër kontrabandës dhe korrupsionit. Besohet se arritjet në këto reforma do të sigurojnë jetëgjatësinë e arritjeve nga politikat makroekonomike.



Acarimi në ekstrem i konfliktit në Kosovë, shpërngulja masive me dhunë e popullsisë së atij rajoni dhe përballimi i një numri tepër të madh të ardhurish (që pothuaj menjëherë arriti në 15 për qind të popullsisë së vendit), si dhe paqartësia e momentit mbi zhvillimet e mëtejshme të këtij konflikti, krijoi përshtypjen se do të ishte e vështirë të zbatohesh programi



ekonomik për vitin 1999. Kështu, Qeveria, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me FMN-në, vendosën të rishikonin objektivat kryesorë makroekonomikë. Duhet theksuar se rishikimi i programit nuk e ndryshonte tërësisht atë. Objektivi për rritjen dhe inflacionin nuk u prek, duke mbetur në nivelet 8 dhe 7 për qind. Objektivi për deficitin e llogarisë korrente në përqindje ndaj PPB-së u rrit në 11.7 për qind nga 8.6 për qind i parashikuar më parë (grafikët 1, 2 dhe 3 pasqyrojnë ecurinë në vite si dhe objektivat finalë të gjithë vitit 1999). Ajo ç'ka parashikohet të mos funksionojë siç duhet është reforma strukturore sidomos procesi i privatizimit.

## **II. Mjedisi makroekonomik global**

### ***Ekonomia Ndërkombëtare.***

Pas një periudhe paqëndrueshmërie të konsiderueshme, që karakterizoi gjysmën e dytë të vitit 1998, duket se kushtet makroekonomike globale janë përmirësuar lehtësisht. Megjithatë, sinjalet, që vijnë nga tregjet botërore financiare dhe treguesit ekonomikë të arritur, janë akoma kontradiktorë për shkak të divergimeve që karakterizojnë ecuritë e blloqeve të mëdha ekonomike dhe paqëndrueshmërive që vazhdojnë në disa nga ekonomitë e vendeve në zhvillim.

Në faktorët pozitivë influencues konsiderohet rritja e ekonomisë amerikane, e cila besohet të jetë më e fuqishme se sa ishte parashikuar fillimisht. Rritja e parashikuar për vitin 1999 do të arrijë në 3.6 për qind, e mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme. Sipas të dhënave të publikuara, gjatë tremujorit të parë të vitit, rritja vjetore e PPB-së të SHBA arriti në 4 për qind, ndërsa shitjet me pakicë u rritën në nivel vjetor me 9.2 për qind. Papunësia vazhdon të mbetet në nivelet e saj më të ulëta historike, në 4.3 për qind (prill 1999). Kjo rritje, mendohet se do të mbështesë rritjen ekonomike globale dhe do të kompensojë ecuritë e dobëta të rajoneve të tjera.

Ndërkohë, Japonia akoma nuk ka shënuar kthesën që pritet në rritjen ekonomike të saj. Të dhënat paraprake flasin për një vazhdim të rënies së ekonomisë (-3.2 për qind për tre muajt e fundit), e ndikuar si nga rënia e prodhimit industrial ashtu dhe nga vazhdimi i dobësimit të kërkesës së brendshme (shitjet e brendshme deri në fund të muajt shkurt ranë me 3.5 për qind). Disa nga ekonomitë aziatike po tregojnë shenjat e para të përmirësimit.

Ka pak fakte që dëshmojnë për një rritje të ekonomisë së zonës të euro-s. Të dhënat në dispozicion tregojnë për një rënie të prodhimit industrial (duke përfshirë sektorin e ndërtimit) në dy muajt e parë të vitit në vazhdim; ndërsa shitjet me pakicë dëshmojnë për një rritje të tyre gjatë tremujorit të parë të vitit 1999 me 2 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Treguesit e besimit të biznesit kanë shënuar rënie të vazhdueshme gjatë tre muajve të fillimit (-1; -3 dhe -4 për qind, respektivisht për muajt janar, shkurt dhe mars), ndërsa treguesi i besimit të konsumatorëve është rritur ndjeshëm (me 12; 12 dhe 11 për qind, respektivisht për muajt janar, shkurt dhe mars). Papunësia u ul lehtësisht, duke arritur në 10.4 për qind në fund të muajt mars kundrejt 10.6 për qind në fund të dhjetorit 1998. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për zonën e euro-s, në fund të muajt mars, shënoi 1 për qind (në bazë vjetore). Pavarësisht nga një rritje e shënuar në çmimet e energjisë (e

ardhur kryesisht nga rritja e taksës mbi energjinë në Gjermani), çmimet e prodhuesve industrialë ranë me 2.7 për qind (shkurt 1999), ndërsa çmimet e mallrave primare shënuan një rënie prej 12.6 për qind (prill 1999). Në tërësi, gjykohet se zhvillimet e çmimeve vazhdojnë të mbeten brenda linjave të parashikuara dhe se objektivat në lidhje me inflacionin janë të arritshëm.

Në valën e krizës monetare – e cila shkaktoi një zhvlerësim prej 40 për qind të monedhës (janar-mars 1999) – Brazili ka hyrë në një periudhë të rënies ekonomike, e cila mund të ndikojë në zhvillimet ekonomike të vendeve të Amerikës Latine. Për shkak të rritjes së shkallës së riskut, hyrjet e kapitaleve private në ekonomitë në zhvillim parashikohet që gjatë vitit në vazhdim të bien. Po kështu, disa nga këto ekonomi do të vazhdojnë të ndikohen nga niveli i dobët i çmimeve të mallrave dhe rënia e kërkesës për lëndë të para. Dhe së fundi, disbalancat në sektorin e jashtëm parashikohet të thellohen, duke çuar kështu në rritjen e presioneve për zbatim të masave proteksioniste.

Si rrjedhojë e veprimit të këtyre forcave me kahje të kundërta, mjedisi ekonomik global vazhdon të jetë i rrethuar nga paqëndrueshmëri të konsiderueshme rreth perspektivave të rritjes së ekonomisë dhe tregtisë botërore.

### ***Zhvillimet në tregjet monetare.***

Tendenca kryesore që karakterizoi tregjet monetare gjatë tremujorit të parë ishte një dobësim i vazhdueshëm i euro-s kundrejt monedhave të vendeve partnere ekonomike të saj, veçanërisht kundrejt dollarit amerikan. Gjithashtu, paqëndrueshmëria e jenit japonez vazhdon të mbetet e lartë si kundrejt dollarit ashtu edhe euro-s.

Kundrejt dollarit amerikan, euro u dobësua gjatë gjithë periudhës, duke u zhvlerësuar në terma nominalë me rreth 10 për qind në fund të muajit maj në raport me nivelin e kuotuar në 4 janar 1999 (data e prezantimit të euro-s). Dobësimi i euro-s kundrejt dollarit erdhi kryesisht nga publikimi i informacioneve rreth rritjes së ekonomisë amerikane më shumë se sa ishte parashikuar. Gjithashtu, parashikimet për ndryshimet e politikës monetare amerikane u zhvendosën nga një lehtësim i mëtejshëm, drejt një shtrëngimi të mundshëm në të ardhmen. Shkëmbimi i jenit japonez kundrejt euro-s pësoi luhatje të rëndësishme, kryesisht si rrjedhojë e sinjaleve kontradiktore rreth drejtimeve të politikave të përgjithshme të vendit. Në fillim të shkurtit, euro u kuotua në 131 jenë japonezë, ose 1.8 për qind poshtë nivelit fillestar të prezantimit të saj. Ndërsa kundrejt sterlinës angleze, në 4 mars euro u kuotua në nivelin 0.68, ose 5 për qind poshtë nivelit të saj fillestar.

### **Ekonomia Kombëtare.**

Sipas të dhënave të disponueshme për **prodhimin industrial** gjatë tremujorit të parë të vitit 1999, me përjashtim të një rritjeje të shënuar në prodhimin e mineralit të kromit dhe të bakrit, me përkatësisht 12 dhe 50 për qind, produktet energjitike, si prodhimi i energjisë elektrike, naftës, qymyrit etj, kanë shënuar rënie. Në tërësi, indeksi i prodhimit të përgjithshëm industrial vazhdoi të mbetet në të njëjtat nivele të tremujorit të fundit të vitit të kaluar dhe -8.4 për qind nën nivelin e tremujorit të parë të vitit 1998. Të gjitha degët e industrisë vazhdojnë të qëndrojnë poshtë niveleve të shënuara në tremujorin e parë të vitit 1998. Ndërsa shenja të vazhdimit të rritjes shfaqen në sektorin e ndërtimit. Duke gjykuar nga konsumi i çimentos (si materiali bazë i ndërtimit), vihet re një rritje prej 14 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Kjo mund të jetë kryesisht rrjedhojë e riaktivizimit të projekteve rrugore dhe veprave të tjera publike. Bazuar në treguesit e konsumit të energjisë elektrike (me një rritje prej 27 për qind kundrejt tremujorit të parë të vitit 1998) dhe tregtisë së jashtme (rritjen prej gati 100 për qind të rieksperteve, në terma nominalë), mund të pohohet se sektori privat vazhdoi të rigjallërojë aktivitetin e tij.

**Financimi i ekonomisë.** Zhvillimet pozitive makroekonomike, si mbajtja në nivele të ulëta e inflacionit, mbajtja nën kontroll e deficitit buxhetor etj, mundësuan lehtësimin e mëtejshëm të kushteve monetare. Mbi këtë bazë, Banka e Shqipërisë, që në fillim të vitit, uli normat minimale të interesave mbi depozitat nga 16.5 për qind në 15.5 për qind, duke krijuar kështu kushte lehtësuese për interesat e kredisë. Ulja e normës minimale të interesit të depozitave me afat në bankat shtetërore u shoqërua dhe me ulje të normave të tjera në përgjithësi, megjithëse shpejtësia e reagimit të tyre dhe masa e uljes janë të ndryshme.

Kështu, bëhet diçka më e lirë huaja e Bankës Qendrore. Norma e rifinancimit ndryshoi nga 22.9 në 21.9 për qind.

Reduktohet kostoja e shërbimit të borxhit të Qeverisë. Norma për bonot e thesarit ulet në intervalin 18.9 – 21 për qind nga 19.9 – 23 për qind për bonot me maturim tre e dymbëdhjetëmujor.

Reduktohet përqindja e interesit të kredive me afat dymbëdhjetë muaj në 26.5 për qind nga 27.4 për qind në janar 1999. Kjo ka ulur më tej koston e marrjes hua. Por, diferenca vazhdon të jetë e lartë. Kjo tregon që instrumenti i përdorur ka më pak efekt te kjo normë.



Gjatë këtij tremujori, kredia gjithësej për ekonominë u rrit vetëm me 8.8<sup>1</sup> për qind (në terma nominalë, kundrejt fillimit të vitit), ndërsa kredia për sektorin privat u rrit me 10.2 për qind. Po kështu, kemi një rritje të peshës specifike të kredisë për sektorin privat ndaj kredisë gjithësej për ekonominë, nga 84 për qind në fund të muajit dhjetor në 88 për qind në fund të muajit mars 1999. Kredia me probleme vazhdon të mbetet në nivele të larta (rreth 55 për qind e kredisë totale). Gjatë tremujorit të parë ajo u ul me 5.1<sup>2</sup> për qind.

Shtrirja e aktivitetit të bankave private në vend dhe vazhdimi i mbështetjes nga projektet e donatorëve për sektorin privat, kanë rezultuar në një rritje të kredisë në monedhë të huaj. Kështu, në fund të muajit mars, ajo u rrit me 1,182 milionë lekë, ose 22.7 për qind mbi nivelin e fundit të vitit të kaluar. Gjithashtu, pesha specifike e kredisë në valutë ndaj kredisë gjithësej për sektorin privat është rritur nga 35 për qind në dhjetor 1998 në 39 për qind në fund të muajit mars 1999. Megjithatë, kredia për ekonominë në raport me PPB-në (me çmime korrente) vazhdon të mbetet në raporte mjaft të ulëta (rreth 4 për qind).

Tek ne, sa herë që flitet për financimin e ekonomisë, të gjithë e barazojnë atë me kredinë e sistemit bankar për biznesin. Në fakt ndodh ndryshe. Të gjithë sektorët e një ekonomie (financiar, privat, individë përfshirë dhe jorezidentët) që disponojnë fonde të lira për të investuar, e konkretizojnë këtë mundësi në institucione të tjera, me rregulla dhe kritere mbikëqyrjeje të përcaktuara si dhe me një etikë dhe reciprocitet të admirueshëm. Në vendin tonë *de jure* prej vitesh ekzistojnë institucione dhe korniza ligjore dhe rregullatore, por, *de facto*, po prej vitesh, efektiviteti i tyre është shumë i ulët.

Mund të thuhet se ndërmjetësimi financiar është në shkallë të ulët. Raporti hua / depozita për sistemin bankar në Shqipëri është nën 20 për qind. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt si me sjelljen e sistemit bankar ashtu edhe “të kursimtarëve”. Popullsia që kursen (kryesisht në Lekë, por edhe në valutë) preferon të çelë llogaritë e saj në Bankën e Kursimeve, edhe sot, kur normat e interesit në këtë bankë janë më të ulëta se në bankat e tjera. Një prirje e tillë kushtëzohet shumë nga të qenit bankë shtetërore ku njerëzit ishin mësuar të depozitonin kursimet e tyre. Bankat e tjera preferojnë të mos punojnë me klientë të vegjël. Ato afrojnë më tepër si depozitues, por edhe si huamarrës, firma me kapital të huaj, mundësisht prej të njëjtit vend.

---

<sup>1</sup> Kjo rritje është më tepër efekt i përfshirjes të stokut të kredive të dhëna nga fondacioni FEFAD në kredinë e dhënë nga sistemi bankar si pasojë e shndërrimit të tij në bankë.


<sup>2</sup> Në të vërtetë kjo ulje ka të bëjë më tepër me ristrukturimin dhe fshirjen nga bilanci të kredive të humbura, se sa me një grumbullim real të tyre.



Nga ana tjetër, tregu i kapitaleve mungon pothuaj tërësisht (mungojnë si instrumentet ashtu edhe “lojtarët e tij”). Mund të renditen disa faktorë shkaktarë të një gjendjeje të tillë. Ato më të dukshmit janë mungesa e tregjeve të tilla në jetën ekonomike shqiptare si dhe moszhvillimi i ekonomisë, që deri në njëfarë mase nuk e kërkon me domosdo zhvillimin e tregut. Megjithatë, në të kundërt të zhvillimit të tregut të kapitaleve ka vepruar edhe:

- ➔ vonesa në privatizimin e “njësive të mëdha ekonomike” gjë që do të realizonte shndërrimin e tyre realisht në shoqëri aksionere. Nevoja e këtyre njësive për të mbijetuar do t’i detyronte të dilnin në treg, qoftë me ofertë aksionesh, qoftë me ofertë letrash me vlerë të borxhit;
- ➔ monopoli që pothuajse ka ekzistuar në disa aktivitete financiare (p.sh., në aktivitetin e sigurimeve). Institucioni i vetëm, që mban monopolin, nuk mund të ketë interes ekonomik (përveçse dëshirës) për të zhvilluar produkte të reja që, gjithashtu, do t’i jepnin shtysë tregut;
- ➔ mungesa e transparencës nga ana e njësive ekonomike shtetërore dhe private në dhënien e informacionit për gjendjen e tyre financiare. Kjo frenon investimin në të tilla njësi, sidomos nga ana e investitorëve të huaj.


**Të ardhurat dhe punësimi.** Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, paga mesatare në sektorin shtetëror shënoi një rritje prej 17.6 për qind (në terma nominalë). Nivelet më të ulëta të inflacionit dhe forcimi i monedhës kombëtare,



bënë që të ardhurat reale të rriteshin më shumë. Ndërkohë, papunësia ka vazhduar të rritet më tej. Punësimi është ulur si nga sektori privat jobujqësor (me rreth 7.5 për qind kundrejt fillimit të vitit) ashtu dhe nga sektori publik (me rreth 5 për qind). Në fund të muajit mars, përqindja e papunësisë

qëndroi në nivelin 17.95 për qind, ose 0.35 për qind mbi nivelin e fillimit të vitit. Vazhdimi i reformave strukturore në administratën publike dhe privatizimi i ndërmarrjeve dhe shoqërive shtetërore do të vazhdojnë të kontribuojnë më tej në thellimin e papunësisë, gjë e cila rrit përgjegjësinë e organeve të qeverisë për forcimin e rrjetit të asistencës sociale dhe për aktivizimin e më shumë programeve të punësimi.

**Çmimet e Konsumit.** Siç është përmendur disa herë më sipër, rritja dymbëdhjetë mujore e çmimeve të konsumit në kufirin 7 për qind, përbën një nga objektivat më të rëndësishëm të programit afatmesëm të zhvillimit të vendit. Tremujori i parë i vitit 1999, tregoi se arritja e këtij objektivi është një realitet<sup>3</sup> i mundshëm. Pas një rritjeje në kufirin 2 për qind, gjatë muajit dhjetor 1998, rritja mujore e IÇK, ka pësuar rënie të konsiderueshme në muajt në



vazhdim, duke zbritur në rreth 1 për qind në muajin janar '99, në -0.6 për qind në muajin shkurt '99 dhe në -0.3 për qind në muajin mars '99.

Pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre përqindjeve në rënie, është ulja e vazhdueshme e përqindjes vjetore të inflacionit, e cila në fund të muajit mars '99 shënonte vetëm 3.2 për qind, nën ndikimin e faktorëve të tillë si: kontrolli mbi ofertën e parasë dhe deficitin buxhetor, stabiliteti i monedhës kombëtare etj.

**Deficiti buxhetor.** Tremujori i parë i vitit 1999 regjistroi një deficit buxhetor në masën 8.3 miliardë lekë ose 1.5 për qind e prodhimit të përgjithshëm të vlerësuar për gjithë vitin 1999. Krahasuar me deficitin e programuar për gjithë vitin 1999, ai përbën vetëm 15 për qind, ndërkohë që më shumë se gjysma e tij është financuar me burime të huaja. Ndër zhvillimet më të spikatura, parë në prizmin e politikës fiskale, në këto muaj do të veçonim prezantimin e kodit të ri doganor.

Politika fiskale e këtij tremujori njohu zhvillime të qeta, në fillim të vitit, ndërkohë që u ballafaqua me një situatë emergjente në ditët e fundit të muajit mars. Vërshimi i qindra mijërave shqiptarëve të Kosovës, krijoi një situatë të paparashikuar ku sfidat ishin të shumta dhe komplekse. U krijuan situata të emergjencës ushqimore, transportit të të shpërngulurve nga zona verilindore në thellësi të vendit, probleme të strehimit etj. Megjithë reagimin e menjëhershëm të komunitetit ndërkombëtar në mbështetje të kësaj situatë emergjente të krijuar, një pjesë e rëndësishme e kostove ekonomike, veçanërisht në fillim të saj, duhej të përballoheshin nga Qeveria Shqiptare dhe

<sup>3</sup> Ndërkohë zhvillimet e dy muajve në vazhdim praktikisht tregojnë se plotësimi i objektivit të inflacionit është pothuajse i arritur.

buxheti i shtetit. Për këtë arsye, Qeveria Shqiptare bllokoi zbatimin e disa projekteve të parashikuara të realizoheshin brenda tremujorit të parë: u bllokuan shpenzimet dhe programet e investimeve të parashikuara në programin buxhetor dhe përdorimin e fondeve, qoftë nga autoritetet e qeverisë qendrore dhe asaj lokale, në funksion të masave të emergjencës; u shtynë afatet kohore të parashikuara për rritjen e pagave në sektorin buxhetor etj.

Aktualisht, situata emergjencës mund të quhet e kaluar me sukses. Që në ditët e para u përllogarit ndikimi i mundshëm i krizës në fjalë ku, përveç shpenzimeve shtesë (rreth 150 milionë dollarë amerikanë), u përllogarit dhe një evazion i mundshëm në mbledhjen e të ardhurave nga dogana (10 milionë dollarë amerikanë). Pavarësisht se komuniteti ndërkombëtar mori në konsideratë një kërkesë të Qeverisë Shqiptare për një financim të drejtëpërdrejtë të buxhetit për rreth 160 milionë dollarë (30 milionë dollarë tashmë janë livruar), zhvillimet faktike të muajve prill e maj, treguan se shpenzimet e bëra ishin në përputhje me nivelet e programuara. Në fund të muajit maj 1999, deficiti buxhetor arriti në 16.8 miliardë lekë, nga të cilat 8.9 miliardë lekë janë financuar nga burime të brendshme. Gjatë kësaj periudhës prill-maj, niveli i shpenzimeve dhe të ardhurave buxhetore përbën përkatësisht rreth 42 dhe 39 për qind të shpenzimeve (57.7 miliardë lekë) dhe të ardhurave (41 miliardë lekë) të realizuara gjatë pesëmujorit të parë të vitit 1999.


Përveç dilemave, që kishin të bënin me ecurinë e të ardhurave, shpenzimeve, financimit të kostove të paparashikuara etj., shumë pikëpyetje qëndronin mbi stabilitetin politik të rajonit, mbi të ardhmen e investimeve në vend, mbi ecurinë e treguesve të tjerë makroekonomikë etj.

Pasojat e kësaj situate, janë reflektuar në vazhdimësinë e reformave strukturore të parashikuara në programin ESAF 2. Rritja e ndjeshme e shkallës së riskut<sup>4</sup> të investimeve në vendet e rajonit të Ballkanit, veçanërisht të vendit tonë, është reflektuar në rënien e interesit të investitorëve të huaj, por edhe investitorëve vendas për të marrë pjesë në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore. Për rrjedhojë, një pjesë e të ardhurave të buxhetit, të parashikuara të arkëtoheshin sipas programit kohor të privatizimit, nuk janë realizuar. Një situatë e tillë pasigurie, ka rezultuar edhe në një tkurrje të aktivitetit investues të firmave që operojnë në tregun e vendit. Kështu, me gjithë rritjen e ndjeshme të importeve të makinerive e pajisjeve kundrejt të njëjtës

---

<sup>4</sup> Sipas EUROMONEY (mars 1999), në renditjen e 180 vendeve sipas shkallës së riskut për të investuar, Shqipëria është zhvendosur nga pozicioni i saj në vendin 135 që zinte në shtator 1998, në pozicionin në vendin 167 në mars të këtij viti.


periudhë të vitit të kaluar, ato mbeten rreth 23 për qind<sup>5</sup> poshtë nivelit të fundit të vitit 1998.



**Zhvillimet në sektorin e jashtëm.** Statistikat e bilancit të pagesave për tremujorin e parë të këtij viti, dëshmojnë për një aktivitet të balancuar e nën kontroll të sektorit të jashtëm. Flukset hyrëse të kapitaleve kanë financuar deficitin e transaksioneve korrente dhe rritjen e rezervave valutore

të Bankës së Shqipërisë.

Transaksionet korrente gjatë tremujorit regjistruan një deficit prej 15 milionë



dollarë amerikanë. Ky deficit përfaqëson vetëm 31 për qind të deficitit të tremujorit të parë të vitit 1998. Zvogëlimi i tij është mundësuar nga rritja e eksportit të mallrave e shërbimeve dhe transfertave korrente.


Shkëmbimet tregtare me botën vlerësohen në 257

milionë dollarë amerikanë dhe janë rritur në total 17 për qind kundrejt tremujorit të parë të vitit 1998. Vëllimi i rritur i transaksioneve tregtare i dedikohet kryesisht rritjes së konsiderueshme të eksportit, dhe ka çuar në zvogëlimin e deficitit tregtar për 18 për qind kundrejt një viti më parë.

Eksportet në tremujorin e parë vlerësohen në 73 milionë dollarë amerikanë. Krahasuar me eksportet e një viti më parë ato janë rritur 73 për qind. Kjo rritje e konsiderueshme është kryesisht efekt i rieksperteve nga përpunimi aktiv (rreth 90 për qind e këtyre eksporteve kanë qenë në tekstile e këpucë).

<sup>5</sup> Në terma të dollarit.

Importi prej 184 milionë dollarë amerikanë vlerësohet 4 për qind më i lartë se në tremujorin e parë të vitit 1998. Kërkesa për mallra importi është rritur kryesisht në grupmallrat “tekstile e këpucë” (rreth 80 për qind e tyre për



përpunim aktiv), “makineri e pajisje” dhe “ushqim, pije, duhan”.

Reduktimi i deficitit korrent është favorizuar, gjithashtu, nga zhvillimet në llogaritë e shërbimeve dhe të ardhurave korrente.

Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve është orientuar kryesisht nga

importi i shërbimeve të transportit të mallrave e të pasagjerëve dhe eksporti i shërbimeve të turizmit.

Transfertat korrente regjistruan një sufiçit prej 85 milionë dollarë amerikanë ose 7 për qind më të lartë së tremujori i parë i vitit 1998. Rritja e transfertave korrente reflekton dërgesa të larta nga emigrantët dhe livrimin e tranfertave shtetërore në *cash* në formën e ndihmës për bilancin e pagesave.

Llogaria kapitale e financiare regjistroi një import neto kapitalesh prej 32 milionë dollarë amerikanë, i cili ka shkuar në favor të rritjes së rezervave valutore dhe financim të deficitit korrent. Influksi i kapitaleve është siguruar nëpërmjet rritjes së detyrimeve financiare për borxhin e jashtëm dhe investimeve direkte.

Në tremujorin e parë rezervat e Autoritetit Monetar u rritën me 16.5 milionë dollarë amerikanë. Stoku i tyre në fund të tremujorit ishte i mjaftueshëm për të përballuar 6.7 muaj importe. Rritja e rezervave valutore është regjistruar në mjetet valutore dhe pozicionin e rezervës në FMN.



### III. Zhvillimet Monetare

Për të kontribuar në arritjen e objektivit të saj kryesor Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 1999, ka përcaktuar si objektiv të ndërmjetëm kontrollin e ofertës së parasë. Deri në fund të vitit është parashikuar që oferta të rritet me rreth 15 për qind.

#### **Treguesit monetarë.**

**Paraja gjithsej** në fund të tremujorit të parë të vitit '99 ka arritur në 250.5 miliardë lekë. Në strukturën e saj depozitat kanë pasur një tendencë rritjeje ndërsa paraja jashtë bankave paraqitet me një tendencë rënieje. Depozitat janë rritur me një ritëm mesatar mujor prej 2.7 për qind.


**Tabela 1. Oferta e parasë (në milionë lekë; fundi i periudhës)**

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	Mar-99
<b>Paraja jashtë bankave</b>	9,897	17,990	27,627	41,906	47,815	72,726	68,323	64,960
Ndryshimi vjetor në %	...	82	54	52	14	52	-6	-5
<b>Rezerva e detyrueshme</b>	...	3,539	4,247	5,678	9,205	12,004	16,952	18,599
Ndryshimi vjetor në %	...	...	20	34	62	30	41	38
<b>Rezervat e tepërta</b>	...	9,605	9,382	5,540	1,958	4,804	3,540	2,025
Ndryshimi vjetor në %	...	...	-2	-41	-65	145	-26	27
<b>Depozita pa afat</b>	7,266	10,242	11,140	17,346	42,591	18,941	15,405	14,718
Ndryshimi vjetor në %	...	41	9	56	146	-56	-19	-10
<b>Depozita me afat</b>	4,764	11,705	18,705	28,117	30,240	70,554	115,535	125,929
Ndryshimi vjetor në %	...	146	60	50	8	133	64	52
<b>Depozita në valutë</b>	6,844	10,248	13,304	20,080	33,906	36,326	40,263	44,893
Ndryshimi vjetor në %	...	50	30	51	69	7	11	26
<b>Baza monetare</b>	...	31,334	42,069	53,877	61,393	90,928	89,887	87,675
Ndryshimi vjetor në %	...	...	34	28	14	48	-1	3
<b>Agregati M1</b>	17,163	28,232	38,767	59,252	90,406	91,667	83,729	79,679
Ndryshimi vjetor në %	...	64	37	53	53	1	-9	-6
<b>Agregati M2</b>	17,163	39,937	57,472	87,370	120,646	162,221	199,263	205,608
Ndryshimi vjetor në %	...	133	44	52	38	34	23	23
<b>Agregati M3</b>	24,007	50,185	70,775	107,449	154,552	198,547	239,526	250,501
Ndryshimi vjetor në %	...	109	41	52	44	28	21	23

Gjatë këtij tremujori kanë ndodhur dy ngjarje që mund të pengonin rritjen e depozitave. Së pari, Banka e Shqipërisë ka ulur nivelin minimal të interesit për depozitat me afat. Së dyti, filloi të zbatohet një taksë e re, taksa mbi të ardhurat prej interesave të depozitave, në masën 10 për qind. Megjithatë, në kushtet e mungesës së alternativave të tjera si dhe mbajtjes së interesave reale pozitive, depozitimi në sistemin bankar ka vazhduar të mbetet tërheqës për publikun.

Niveli i **parasë jashtë bankave** për tremujorin e parë të vitit 1999 paraqitet në rënie. Krahasuar me fundin e vitit 1998, ky tregues është zvogëluar me rreth 3.3 miliardë lekë. Ndryshimi vjetor negativ në këtë tregues është një fenomen që vërehet nga muaji maj 1998 mesatarisht me 8 për qind çdo muaj.

Ndonëse me ritme më të ulëta, rënia e **depozitave pa afat** vazhdoi pa ndërprerje edhe gjatë tremujorit. Krahasuar me fundin e vitit 1998, ato ranë me 700 milionë lekë (- 4.5 për qind), ndërsa ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar rënia rezulton të jetë 10 për qind.



**Depozitat me afat**, në tremujorin e parë të vitit 1999, kanë vazhduar të rriten me një ritëm mesatar mujor prej 2.8 për qind duke arritur në fund të marsit një nivel prej 147.5 miliardë lekë.

**Agregatet Monetare.** Në tremujorin e parë të vitit 1999, agregati M1 pati

luhatje të vogla dhe qëndroi në një nivel mesatar mujor prej 78.8 miliardë lekë.

Agregati M2 ka vazhduar tendencën në rritje të vënë re dhe muajt e mëparshëm duke arritur nivelin më të lartë në fund të marsit në 205.6 miliardë lekë dhe me një rritje prej 3.18 për qind në krahasim me dhjetorin '98.

Agregati M3 është rritur gradualisht dhe si tremujor ka arritur në 4.58 për qind duke reflektuar në njëfarë mase dhe rritjen e vazhdueshme të depozitave në valutë gjatë këtij tremujori.

Vlen të theksohet se dhe struktura e agregateve monetare ka ndryshuar në favor të uljes së presioneve inflacioniste nga ana e tyre mbi ekonominë, duke përmendur që raporti i agregateve M1/M3 në tremujorin e parë të vitit 1999, nga 35 për qind në dhjetor të vitit 98, është ulur në 31.8 për qind.

Përsa i përket kreditit të brendshëm ai është ulur në total vetëm me 0.47 për qind ndaj dhjetorit të vitit 1998, prej të cilit 91 për qind përbëhet nga kredia për Qeverinë dhe vetëm 9 për qind është kredia për ekonominë. Peshën më të madhe në strukturën e kreditit për ekonominë dhe për këtë tremujor të parë të vitit 1999 e zë kredia për sektorin privat, që ka shënuar dhe një rritje relativisht të ndjeshme prej 10.1 për qind në krahasim me dhjetorin '98.



**Objektivat dhe kufijtë e programuar për tremujorin e parë të vitit 1999.**

Në tremujorin e parë të vitit 1999 janë realizuar të tre objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë të parashikuar në programin ESAF 2.

Kufiri i sipërm i kredisë së sistemit bankar për Qeverinë për tremujorin e parë të vitit 1999 është realizuar nën nivelin e programuar prej 5.7 miliardë lekë.

Kufiri i poshtëm për mjetet e huaja neto të Bankës së Shqipërisë nga 178.2 milionë dollarë amerikanë që është programuar për tremujorin e parë të vitit '99 është në vlerën prej 207 milionë dollarë amerikanë, pra rreth 28.8 milionë dollarë amerikanë mbi nivelin e programuar.

Kufiri i sipërm i mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë ka arritur në nivelin 58.6 miliardë lekë ndaj 67 miliardë lekë që ishte programuar.

Realizimi i objektivave të vendosur për këta tregues është vërejtur dhe në dy muajt në vijim (prill, maj). Duhet theksuar që niveli i mjeteve të huaja neto të Bankës së Shqipërisë ka vazhduar të rritet dhe është ndjeshëm mbi nivelin e programuar (përkatësisht 35.7 milionë dhe 71.3 milionë dollarë amerikanë mbi objektivat). Si arsye kryesore për këtë mendohet të jenë hyrjet e konsiderueshme në valutë në formë ndihme nga komuniteti ndërkombëtar për mbështetjen e shpenzimeve buxhetore për përbalimin e situatës së krijuar nga refugjatët si dhe nga prirjet për mbiçmim të monedhës kombëtare.

Ndërkohë mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë janë nën nivelin programuar përkatësisht 7.3 dhe 10.8 miliardë lekë për muajt prill e maj. Për muajin prill kredia neto e sistemit bankar për qeverinë paraqitet me 1 miliardë lekë nën kufirin e vendosur në ESAF 2.

\* \*

\*

Zhvillimi më i spikatur i këtij tremujori përkon me shmangien e ndikimit të konfliktit dhe të të ardhurve nga Kosova mbi çmimet e konsumit. Situata emergjente në fund të tremujorit të parë të vitit 1999, jo vetëm që nuk tronditi ekuilibrin e vendosur por, përkundrazi, në bashkëpunim të frytshëm me faktorin ndërkombëtar, u arrit të menaxhohej.

Tiranë, më 24.06.1999